



TELESKOPI HAPËSINOR JAMES WEBB

SHQIP

Do të jetë observatori kryesor i hapësirës për astronomët në mbarë botën, duke zgjeruar zbulimet mbresëlënëse të Teleskopit Hubble të Hapësirës.

Një bashkëpunim ndërkombëtar midis NASA-s, Agjencisë Hapësinore Evropiane dhe Agjencisë Hapësinore Kanadeze.

Teleskopi më i madh i vendosur ndonjëherë në hapësirë; 100 herë më i fuqishëm se Hubble.

Është aq i madh sa do t'i duhet të paloset për t'u futur në raketë dhe do të shpaloset në hapësirë si një "Transformer".

Ka një mbulesë prej 5 shtresash që mbron teleskopin nga rrezatimi infra i kuq i Diellit, Tokës dhe Hënës; njësoj si të ketë një mbrojtje nga dielli me një faktor prej 1 milion SPF.

Me një ndjeshmëri të pashembullt në infra të kuqe, do të depërtojë pas në kohë mbi 13.5 miliardë vjet, për të parë lindjen e galaktikave të para pas Big Bang-ut.

Do të rrotullohet rreth Diellit 1.5 milion kilometra larg Tokës. (Hubble ndodhet 560 kilometra mbi sipërfaqen e Tokës.)